# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-472170**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Humori, Parlamenti apo qeveria: Kush të bën të qeshësh më shumë?” |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/26/humori-parlamenti-apo-qeveria-kush-te-ben-te-qeshesh-me-shume/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 17:12:31 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 26 shtator 2026, 17:07:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 26 shtator 2026, 17:06:00 UTC → 26 shtator 2026, 17:08:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5f08cc16923644d8385d07596dbeb91b94c6c16a9299da8bac106156a9eb495f` |
| TEKSTI | `2a7fe7e7ab0a42268f0d6646ccfc786dcfe8b7ad8f2482100520e63afda8f890` |
| PAMJA | `84c8d0a879692552a612847b53754cdc2d0cf29ea5681adcae7b41c5f4a20f33` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `bbfe18f30cb3dc54c01078d9d7f538ead596441705ce6137caa3f4c6386cbe01` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f11c1668384a0114026088dd439e5bbabdb3d48a586475de97c9d12c35b4ba6b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/bbfe18f30cb3dc54c01078d9d7f538ead596441705ce6137caa3f4c6386cbe01`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Humori, Parlamenti apo qeveria: Kush të bën të qeshësh më shumë?”

26/09/2026 19:07



**Nga Filip Çakuli**

Shqipëria ka mbetur pa humor. Për fat, ka qeveri.

Dikur Shqipëria kishte estradë.

Jo vetëm në Tiranë. Kishte në çdo qytet. Estrada e Shkodrës, e Durrësit, e Korçës, e Vlorës, e Elbasanit… Secili qytet kishte njerëzit e vet që këndonin, luanin, bënin skeçe dhe, mbi të gjitha, dinin të bënin shqiptarët të qeshnin.

Dhe qeshnin. Natyrisht jo humor politik, se kishte censurë dhe autocensurë. Po tallja me zakonet, burokracinë, dukuritë e përditshme ekzistonte. Dhe lejohej.

Të premten ose të shtunën mbrëma, televizori ishte gati. Televizioni Shqiptar sillte humorin e estradave nga gjithë vendi. Kishte këngë, parodi, personazhe, batuta. Kishte humor me komshiun, me nëpunësin, me vjehrrën, me policin, me shefin, me burokracinë dhe, kur guxonte, edhe me pushtetin.

Ishte një Shqipëri me një televizor në shtëpi, por me shumë humor.

Sot kemi dhjetëra televizione dhe shumë më pak humor.

Estradat u zhdukën, skenat u boshatisën, trupat artistike u tretën dhe humori shqiptar u bë pak a shumë si një specie në zhdukje. Dikur çdo qytet kishte estradën e vet. Sot çdo qytet ka të paktën një televizion lokal, disa portale, dhjetëra studio dhe qindra njerëz që flasin seriozisht.

Shumë seriozisht.

Ndoshta ky është problemi.

Shqiptarët kanë shumë arsye për të qeshur, por shumë pak vende ku mund të qeshin.

Sot, në televizion, hapësira e vetme e humorit mbetet Portokallia e Top Channel-it. Një grup aktorësh të talentuar vazhdon të mbajë gjallë një traditë që dikur ishte shumë më e gjerë. Tashmë në drejtimin e saj është Agron Llakaj, aktor me përvojë të gjatë në humor, që nuk është vetëm interpretues, por edhe krijues e shkrues i materialeve që luan.Sot Portokallia duhet të marrë përsipër barrën e rëndë për t’i bërë shqiptarët të qeshin. Pse them barrë e rëndë. Se mbetën vetëm dhe u bie barra. Se janë pjesë e Topit dhe u shtohet barra e përgjegjesisë.

Topi është i pari, kështu që Portokallia nuk mund të jetë e dyta…

Dhe pikërisht këtu lind pyetja:

Pse të mos i japim humorit atë që Shqipëria prodhon më shumë se çdo fabrikë:

## Kryesore



Nga mbrojtja e rritja ekonomike te lufta kundër grupeve kriminale transnacionale, Ambasada Amerikane tregon prioritetet e ambasadorit të ri të Trump në Tiranë
15:54

Aksident i rëndë në Thumanë, tre mjete përplasen me njëra-tjetrën, humb jetën një 19-vjeçar, plagosen dhe dy persona
07:38

SPAK aksion në Shkodër e Tiranë për arrestimin e personave me rrezikshmëri të lartë, një në pranga, Endrit Dokle shpallet sërish në kërkim
10:57

Atentat në Athinë, katër persona hapën zjarr drejt një kafeneje, plagoset një fëmijë shqiptar
07:59

Teherani ofroi armëpushim 7-ditor, Wall Street Journal: Trump e refuzoi dhe kërkoi që bombardimet ndaj Iranit të vijojnë pas zgjedhjeve të nëntorit
08:12

## Më të lexuarat

Pushimet kthehen në tragjedi, motër e vëlla nga Shqipëria dhe partnerët e tyre humbin jetën pas shembjes së godinës në Athinë

Fusha kthehet në ring! Lukaku bën gjestin e turpshëm ndaj italianëve, Donnarumma humb toruan dhe vërsulet drejt tij

Shpërthimi i fuqishëm në Athinë ku humbën jetën 3 shqiptarë, ekipet e emergjencës nxjerrin trupat e 6 viktimave nga rrënojat

Berisha pa ftesë për ceremoninë e prezantimit të Wendt si ambasador i SHBA në Shqipëri, kreu i PD: Nuk jam ftuar as për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare

Statusi i Saimir Tahirit në Facebook, miqtë e tij tregojnë për Top Channel çfarë pritet të thotë ish-ministri i brendshëm socialist

Ish-agjenti i CIA u sugjeron amerikanëve të jetojnë në Shqipëri, Bustamante: Nëse do të doja të zhvendosesha në Evropë, Shqipëria do të ishte në radarët e mi

U arrestua me urdhër të SPAK, kush është 50-vjeçari që njihet si “i forti i Shkodrës”, pjesë edhe e grupit ‘Rraja’

“Disa histori i kam jetuar, të tjera…”, çfarë po paralajmëron ish-ministri Tahiri, publikon videon ‘enigmatike’: Kam shumë për të thënë

politikën?

Sepse lënda e parë nuk na mungon.

Përkundrazi, kemi mbiprodhim.

Qeveria prodhon materiale humoristike çdo ditë, pa pasur nevojë për autorë. Ministrat prodhojnë personazhe. Parlamentarët prodhojnë dialogë. Fjalimet prodhojnë skeçe. Konferencat e shtypit prodhojnë monologë. Deklaratat politike prodhojnë batuta.

Dhe, ç'është më e bukura, janë të gjitha falas.

Një autor humori mund të kalojë tri ditë duke menduar një batutë.

Politika ta jep për tre minuta.

Një skenarist mund të lodhet duke krijuar një personazh grotesk.

Pastaj del një zyrtar në televizor dhe ia prish gjithë punën: personazhi real është më grotesk se ai imagjinar.

Dikur humoristi duhej të shpikte situatën.

Sot mjafton të ndezë televizorin.

Madje, me ritmin e politikës shqiptare, humoristi rrezikon të mos e kapë aktualitetin.

Shkruan një skeç të hënën.

Të martën ndryshon qeveria.

Të mërkurën ndryshon deklarata.

Të enjten ndryshon versioni.

Të premten humoristi e heq skeçin sepse realiteti e ka tejkaluar.

Të shtunën e merr prapë.

Sepse realiteti ka prodhuar një tjetër.

Kjo është ndoshta e vetmja industri shqiptare që nuk ka nevojë për investitor strategjik.

Ka lëndë të parë pafund.

Por humori politik nuk do të thotë thjesht të tallësh politikanin. Do të thotë të bësh atë që ka bërë gjithmonë humori i mirë: të tregosh absurditetin e jetës përmes së qeshurës.

Një ministër mund të bëhet personazh.

Një mbledhje qeverie mund të bëhet skeç.

Një konferencë shtypi mund të bëhet parodi.

Një debat parlamentar mund të kthehet në teatër.

Një deklaratë politike mund të marrë vendin që dikur kishte batuta e estradave.

Dhe publiku mund të qeshë me pushtetin pa pasur nevojë ta urrejë.

Sepse humori nuk është vetëm armë politike. Është edhe mënyrë për të mos u marrë shumë seriozisht nga ata që merren shumë.

***Shënim: Ky shkrim është ekskluziv për Top-channel.tv***

**Top Channel**


**Detaje/ Atentati në Athinë ku mbeti e plagosur 10-vjeçarja shqiptare, urdhri u dha nga i burgosuri 'i famshëm', babai i të miturës pronar i lokalit**

**Atentat në Athinë, katër persona hapën zjarr drejt një kafeneje, plagoset një fëmijë shqiptar**

## Kryesore »



**Zjarr pranë tunelit të Krrabës, flakët përfshijnë dhe djegin plotësisht një autobus**

26/09 18:25



**Tre të rinjtë shqiptarë humbën jetën në Greqi, dëshmia rrëqethëse e mikes së familjes: Çifti i ri sapo ishin martuar,**



**La pas Skelën, Bogdanin e Salihin, zbuloni sulmuesin që dominon historinë e rrjetave ndaj bjellorusëve**

prisnin fëmijën e parë

26/09 17:33

26/09 17:26




Tensionet SHBA-Iran, Trump konfirmon refuzimin e armëpushimit: Teherani ofroi rihapjen e Hormuzit dhe rikthimin në negociata

26/09 17:14



Komisioni Hetimor për zgjedhjet e 11 majit, PD kërkon nisjen e procedurave: Vendimi i Kushtetueses është detyrues

26/09 16:51




Statusi i Saimir Tahirit në Facebook, miqtë e tij tregojnë për Top Channel çfarë pritet të thotë ish-ministri i brendshëm socialist

26/09 16:36

## Opinion »



Opinion nga Lorenc Vangjeli: Ish-shefja e SHISH nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj

25/09 20:50



"Urgjenca e SPAK-ut për ta bërë publik arrestimin fsheh një hall të madh"/ Analiza e Filip Çakulit: Vlora Hyseni dhe misteri i certifikatës së sigurisë

23/09 18:25



Ku janë provat materiale? 96 vrasje – 96 viktima – 96 dosje provash!

23/09 18:20



Shqipja ka nevojë për një rinovim digjital

23/09 13:43



Tani i Madh, Topi i Madh

22/09 19:21



Rugova dhe Jusuf Gërvalla, forca e një modeli

22/09 19:20

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News- Vuçiç merr garancinë e Putinit para dorëheqjes, zbulohen kërkesat e Beogradit për Moskën



Top News – 'Vlora Hyseni po u kthen reston tradhtarëve'/ Berisha: Zhvillimet do të jenë të bujshme



Top News – Destinacioni sekret/ Wizz Air sjell në Aeroportin e Rinasit 150 turistë surprizë



Top Channel/ Zjarr pranë tunelit të Krrabës, flakët përfshijnë dhe djegin plotësisht një autobus



Top News – Shkuan për të festuar muajin e mjaltit. Shqiptarët humbin jetën në tragjedinë në Athinë



Top News- I dënuar me 6 vite burg për drogë, arrestohet në Krujë 41-vjeçari

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Politikë | Koment | Kategoria Superiore | Lifestyle | Për'puthen | Kontakt |
| Kronikë | Kosova dhe Rajoni | Kategoria e Parë | Fashion | Shqipëria LIVE | Bileta – Portokalli |
| Aktualitet | Shkencë dhe Teknologji | Premier League | Shëndeti | Fiks Fare | Puno në Top Channel |
| Ekonomi | Auto | La Liga | Dieta | Video | Privacy Policy & Terms of Use |
| Sociale | | Serie A | Receta gatimi | Të gjitha programet | Aksesueshmëria |
| Video | | Shumësportësh | | Guida TV | |
| Top News LIVE | | Sport Gossip | | | |

**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.